

ESPIG opganizon seminar per ardhmerine ekonomike te Kosoves

Kosova edhe me tej mbetet pa vizion ekonomik

"Ne shikim te pare, prioritetet duken te shumta, prandaj 'prioritetet e prioriteteve', qe mund te jene: permiresimi dhe arsimi", ka thene Bajram Rexhepi

MVSA MUSTAFA &

ZEDINKRASNOI

MitrovicE, 15 KORRIK - Diskutimi i nje vizioni ekonomik per Kosovendhe identifikimi i prioriteteve per zhvillim, jane diskutuar ne MitrovicE ne nje seminar te organizuar te enjten nga Grupi per Strategji Ekonomike dhe Identifikim i Projekteve (ESPIG), ne bashkepunim me Iniciativen per Stabilitet ne Evrope (ESI) dhe perkrahje te Departamentit per Zhvillim Nderkombetar (DFID).

politikave nga IPVQ, shoqerise civile kosovare, perfaqesuesit e UNMIK-ut si dhe donatoret, ne nje perpjekje per te ndertuar nje konsensus per sfidat e zhvillimit te Kosoves si dhe per zgjedhjet e mundshme dhe prioritetet e politikave. Kryeministri i Kosoves, Bajram Rexhepi, kete ceshtje e vleresoi si nje problem qe nuk duron vonese, per te shtuar se Kosova sot gjendet ne nje situatë shume delikate. "Duke marre parasysh renien drastike te donacioneve,

financiar, privimin nga Kredite e huaja deri me tani, si dhe barrierat e tjera, Kosova gjithnje me shume po ndien mungesen e kapitalit per financimin e projekteve te nevojshme", tha Rexhepi, duke shtuar se "Kosova nuk mund te zhvillohet pa ndihme nga jashte, ndersa qe nevoja me e madhe eshte per grante qe nuk e rendonje buxhetin e saj".


Sidoqofte, sipas kryeministrit, "sigurimi i mjeteve financiare nuk mjafton per te gjeneruar prosperitet ekonomik dhe Stabilitet politik". Ndersa qe theksoi se "ne duhet pikesepari t'i qartesoje se si, ku dhe kur do te behet perdorimi i ketyre mjeteve, perdorimi i tille qe perkrah projekte me potential te deshmuashem per te gjeneruar: rritje te ekonomise, ulje te papunesise, permiresim te kushteve sociale dhe zhvillim te gjithmbarshem".

Ky qartesim se si Kosova me se miri mund te mobilizojë e te orientoje te gjitha mundesite, sipas Rexhepit, duhet te vijë nga strategjia e zhvillimit, pra nga nje plan kombetar i zhvillimit. "Jam i bindur se nje plan, apo strategji e tille e zhvillimit eshte i domosdoshem, sepse na qarteson te gjithë neve hartues te politikave, qofte vendas apo nderkom-

betare, se ku duhet t'i theksojme kapacitetet tona vendimmarrese per te permiresuar kushtet per zhvillim", tha Rexhepi. Sidoqofte, sipas kryeministrit Rexhepi, per sajimin e nje strategjie te tille nuk ekziston nje pergjigje e qarte por qe si u shpreh ai, duhet sajuar pergjigjen. "Mendoj se nje strategji e mire pikesepari do te bente identifikimin e qarte te prioriteteve. Ne shikim te pare, prioritetet duken te shumta, prandaj eshte mjaft me rendesi te qartesohen se cilat jane 'prioritetet e prioriteteve', qe mund te jene: permiresimi i infrastruktures publike, zhvillimi i sektorit privat dhe arsimi", ka thene Rexhepi. Nderkaq, ministri per Ekonomi dhe Financa, AH Sadriu, tha se Kosoves i mungojne shume parakushte per nje strategji dhe sipas tij ajo duhet te kete kornize te zhvillimit ekonomik. Sipas tij, vetem privatizimi mund te shpie me vrullshem drejt ekonomise se qendrueshme te tregut. Sipas ministrit, ESPIG ka punuar vetem brenda zyres se kryeministrit dhe kjo, si u shpreh ai, mund te kete pasoja per zhvillimin ekonomik te Kosoves. Ne rrethanat aktuale Kosova nuk

ka burime te tjera te formimit te buxhetit, perveç atyre vetjake dhe kjo paraqet pengese te zhvillimit. Nderkaq, keshilltari i ministrit Sjadriu, Mixhait Reci, ka theksuar se te hyrat nga kufiri, qe ne kete vit sillen mbi 70 per qind, sipas nje program! te kesaj Ministrie ne vitin 2009 do te zbresin ne 60 per qind, duke nenvizuar se kemi nje rritje ekonomike te bruto produktit vendor prej 4 per qind. Ai tha se verehet nje tendence e rritjes se shpenzimeve kapitale kudruall shpenzimeve te tjera. Ne kete seminar Gernard Knaus nga ESI dhe John Bradley, kane paraqitur nje draft per diskutim per vizionin ekonomik: ku qendrojmë dhe ecja perpara. "Ne mungese te nje strategjie realiste te zhvillimit, gjendja e tan-ishme e rende ekonomike eshte e sigurt se do te perkeqesohet edhe me tej, ndersa qe ne mungese te ndihmes financiare nga nderkom-betaret parashikimet per permiresim ekonomik jane te large-ta", eshte theksuar ne draftin nga diskutuesit.

"Ata qe i bejne politikat ne Kosove duhet te jene shume te vemendshem per ndikimin qe zgjerimi i fundit i BE-se do te kete ne zhvillimin e tyre ekonomik", tha Knaus. Ai tha se perkunder perkufizimeve te resurseve ne Kosove, nje fillim i menjehershëm mund te behet per te adresuar dhe disenjuar nje plan te zhvillimit kombetar te Kosoves, duke marre edhe pervojat nga vendet qe kane kaluar si Irlanda apo nga ato qe jane duke e nisur si Estonia, Lituania, Sllovenia dhe Bullgaria.



Seminari ka bashkuar hartuesit e mungesen e nje tregu te zhvilluar